



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA DURRËS
KËSHILLI BASHKIAK

VENDIM

Nr. 12, datë 13.01.2023

PËR
MIRATIMIN E NJË NDRYSHIMI NË ANEKSIN NR.1, TË VENDIMIT TË KËSHILLIT
BASHKIAK NR.154, DATË 22.12.2022 , PËR FAMILJEN LOÇI

Në zbatim të nenit 113, pika 2, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, Ligjit nr. 139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore” i ndryshuar, Aktit Normativ nr. 9, datë 16.12.2019 “Për përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore”, miratuar me Ligjin nr. 97/2019, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr.904, datë 24.12.2019 “Për përcaktimin e rregullave, të kategorive prioritare, masës së përfitimit, autoriteteve përgjegjëse dhe procedurave për vlerësimin dhe përzgjedhjen e përfituesve nga disa programe të procesit të rindërtimit, si edhe sipas relacionit të 2 komisioneve të përhershëm të këshillit, me propozim të Komisionit të Rregullores, Çështjeve Ligjore dhe Komisionit të Strehimit dhe Shërbimeve Publike,

KËSHILLI BASHKIAK
V E N D O S I :


1. Ndryshimin e Vendimit Nr. 154, datë 22.12.2022 të Këshillit Bashkiak, Bashkia Durrës sa i përket qytetarit znj. Lluiza Loçi dhe z. Kristjan Loçi.
2. Miratimin e listës së përfituesve nga programi i procesit të rindërtimit, sipas Relacionit të hartuar nga Komisioni i Rregullores, Çështjeve Ligjore dhe Komisioni i Strehimit dhe Shërbimeve Publike, për:
Znj. Lluiza Loçi dhe z. Kristjan Loçi strukturë 2+1.

3. Ngarkohet për zbatimin e këtij vendimi Drejtoria e Shërbimeve Publike, Bashkia Durrës.

Ky vendim hyn në fuqi sipas përcaktimeve të nenit 55, pika 6, të Ligjit Nr.139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore”, i ndryshuar.

KRYETAR I KËSHILLIT BASHKIAK

Ani Dyrmishi



U shpall sot me datë 16.01.2023





BASHKIA Durrës

26.01.23 342/12

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
PREFEKTI I QARKUT Durrës

Nr. 49/12 prot.

Durrës, më 24.01.2023

Lënda: Verifikim i ligjshmërisë së aktit

**KËSHILLIT BASHKIAK
Durrës**

**KRYETARIT TË BASHKISË
Durrës**

Verifikova ligjshmërinë e Vendimit të Këshillit Bashkiak Durrës Nr. 12 datë 13.01.2023 “Për miratimin e një ndryshimi në aneksin nr.1, të Vendimit të Këshillit Bashkiak nr.154, datë 22.12.2022 , për familjen Loçi”

Ky vendim në bazë të Ligjit nr 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative” neni 3 pika 2 nuk është akt me karakter normativ. Vendimi është akt administrativ individual bazuar në nenin 3 pika 1/a të Ligjit nr 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative”, pasi i drejtohet subjekteve të përcaktuar individualisht duke krijuar një marrëdhënie juridike konkrete si dhe është i shteruar në zbatimin e tij.

Në bazë të Ligjit Nr.107/2016 “Për Prefektin e Qarkut” (neni 8/a) “Prefekti i qarkut verifikon ligjshmërinë e vendimeve, urdhrave dhe urdhërësive me karakter normativ të organeve të vetëqeverisjes vendore”.

Për sa më sipër verifikimi i këtij vendimi duke qenë një akt administrativ me karakter individual **nuk është në kompetencën e Prefektit të Qarkut.**

Duke ju falenderuar për bashkëpunimin.

PREFEKTI

EMILJAN JANI

